



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
University "Ukshin Hoti" Prizren

KËSHILLI DREJTUES

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerzitet Prizrena "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt. 20.04.2018	
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-120

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. asoc. dr. Bedri Muhadri

Nr. i ref. 30-2018

Prizren, 20.04.2018

Mbështetur në dispozitat ligjore të nenit 23, paragrafi 1.6, alineja 1.6.2, të Statutit të Universitetit 'Ukshin Hoti' Prizren, sipas referencës nr. 04-V-621, datë 30 maj 2013, Këshilli Drejtues, duke vendosur në lidhje me miratimin e Rregullores për të ardhura personale të personelit administrativ në Universitetin "Ukshin Hoti", në mbledhjen e mbajtur me datë 20.04.2018, mori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Rregullorja për të ardhura personale të personelit administrativ në Universitetin "Ukshin Hoti".
- II. Pjesë përbërëse e këtij vendimi do të jetë edhe Rregullorja e sipërhënuar.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Duke pasur parasysh domosdoshmërinë për hartimin e një rregullore e cila përcakton burimet financiare si dhe lartësinë e shumës për kompensimin e personelit administrativ të UPZ-së. Vlen të theksohet se kjo rregullore është hartuar në pajtim me rekomandimin e grupit punues të formuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MASHT-it sipas vendimit nr. 02-2495, datë 07.07.2017 në lidhje me shkrirjen së shtesës stimulative në pagën bazë dhe unifikimin e pagave për personelin administrativ Universitetet Publike nën programe të MASHT-it. Prandaj mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues i Universitetit "Ukshin Hoti" vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

1. Këshillit Drejtues,
2. Menaxhmentit,
3. Sekretarit të Përgjithshëm,
4. Shërbimit të Financave, Personelit dhe
5. Arkivit.

Kryesues i Këshillit Drejtues

Prof. asoc. dr. Bedri Muhadri





UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI"
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI"

KËSHILLI DREJTUES

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt. 20.04.2018	
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-120

Pruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. asoc. dr. Bedri Muhadri

Nr. i ref. 30-2018 Prizren, 20.04.2018

Mbështetur në dispozitat ligjore të nenit 23, paragrafi 1.6, alineja 1.6.2 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, sipas referencës nr. 04-V-621, datë 30 maj 2013, Këshilli Drejtues, duke vendosur në lidhje me miratimin e Rregullores për të ardhura personale të personelit administrativ, në mbledhjen e mbajtur me datë 20.04.2018, miratoi këtë:

RREGULLORE

Për të ardhura personale të personelit administrativ në Universitetin "Ukshin Hoti"

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Mjetet për të ardhurat personale shfrytëzohen nga fondi i Buxhetit të Republikës së Kosovës, nga tarifat e shkollimit dhe pagesat tjera të cilat i bëjnë studentët; gjithashtu nga pagesat e shërbimeve komerciale si donacion, dhuratat si dhe nga kontratat me organizma kombëtar dhe ndërkombëtar publik dhe privat. Nga këto burime financiare paguhen të ardhurat personale dhe kompensimet tjera sipas dispozitave ligjore në fuqi për personelin administrativ të universitetit "Ukshin Hoti" Prizren (në tekstin e mëtejshëm: Universiteti).

II. DISPOZITAT E VEÇANTA

Neni 2

Personeli i administratës së Universitetit "Ukshin Hoti" i nënshtrohet Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës, legjislacionit përkatës në fuqi, Statutit të Universitetit dhe akteve tjera të brendshme.

Neni 3

Shërbimi për financa i Universitetit bën përlllogaritjen e të ardhurave personale dhe pagesave tjera të përcaktuara në bazë të kësaj rregulloreje, ligjeve dhe akteve tjera nënligjore në fuqi, si dhe në bazë të vendimeve të veçanta të nxjerra nga organet kompetente të UPZ-së.

Neni 4

PAGESAT PËR PERSONELIN E ADMINISTRATËS SË UNIVERSITETIT

Vendi i punës:	Shtesë është e caktuar me vendim të veçantë të Qeverisë	Paga Bruto	SHCK
Sekretar i Përgjithshëm	0.00	1,485.90	31.20
Sekretar i Fakultetit	0.00	799.50	31.20
Drejtor	0.00	799.50	31.20
Menaxher i Personelit Udhëheqës i Zyrës- Njësisë - Divizionit	0.00	799.50	31.20
Auditor i Brendshëm	0.00	907.19	31.20
Zyrtar Certifikues	0.00	520.00	31.20
Zyrtar për Infrastrukturë dhe Logjistikë	250.00	520.00	31.20
Zyrtar për Buxhet dhe Financa	0.00	520.00	31.20
Zyrtar për Komunitete dhe Mundësi të Barabarta	0.00	520.00	31.20
Zyrtar i Lartë i Personelit	0.00	520.00	31.20
Zyrtar Ligjor	0.00	520.00	31.20
Zyrtar për Paga	0.00	520.00	31.20
Zyrtar për të Hyra	0.00	520.00	31.20
Zyrtar për Shpenzime	0.00	520.00	31.20
Zyrtar për Zotime	0.00	520.00	31.20
Zyrtar për Komunikim me Media	0.00	520.00	31.20
Zyrtar për Përkthime	0.00	520.00	31.20
Zyrtar për Redaktim dhe Lekturë	0.00	520.00	31.20
Zyrtar i Prokurimit	0.00	520.00	31.20
Zyrtar për Pasuri dhe Asete	0.00	520.00	31.20
Zyrtar i Lartë për Çështje Akademike	0.00	520.00	31.20
Zyrtar i Lartë për Zhvillim Akademik	0.00	520.00	31.20
Zyrtar i Lartë i Shërbimit të Studimeve Postdiplomike	0.00	520.00	31.20
Zyrtar i Lartë i Shërbimit të Studimeve BA	0.00	520.00	31.20
Zyrtar i IT-së	200.00	520.00	31.20
Zyrtar i Arkivit Qendror	0.00	490.10	31.20
Zyrtar për Diploma	0.00	490.10	31.20
Zyrtar për Pranim dhe Lirim	0.00	490.10	31.20
Zyrtar Administrativ në KD	0.00	490.10	31.20
Asistent në Zyrën e Rektorit	0.00	490.10	31.20
Asistent në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm	0.00	490.10	31.20
Vozitës i Rektorit/Universitetit	0.00	430.56	31.20
Depoist	0.00	430.56	31.20
Zyrtar i Shërbimit të Studentëve	0.00	460.20	31.20
Zyrtar i IT-së në Fakultet	200.00	460.20	31.20
Zyrtar Teknik për Laborator	0.00	490.10	31.20
Zyrtar për Bibliotekë	0.00	460.20	31.20

Neni 5

5.1 Paga për nëpunësit e administratës në Universitetin “Ukshin Hoti”, të caktuara me këtë rregullore do të zbatohen deri në miratimin e ligjit të pagave për të gjithë nëpunësit civil në nivel të Republikës së Kosovës. Nivelimi dhe harmonizimi i pagave për nëpunësit civil do të bëhet mbi bazën e Klasifikimit të pozitive dhe gradave të pagesës në shërbimin civil të cilat do të përcaktohen dhe miratohen nga Ministria përgjegjëse për administratë publike në përputhje me katalogun.

5.2. Universiteti “Ukshin Hoti” mund të caktojë shtesa mbi pagën bazë, me vendim të veçantë të Këshillit Drejtues.

5.3. Për të gjitha pozitat të cilat nuk janë përfshirë në këtë rregullore, ndërsa janë paraparë në rregulloren për organizimin të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës, do të zbatohet lartësia e pagës bazë ekuivalente me pozitën e kategorisë së njëjtë apo të ngjashme deri në harmonizimin e pagave për të gjithë nëpunësit civil në nivel të Republikës së Kosovës.

5.4. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje në ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Universitetit, shfuqizohen të gjitha rregulloret, vendimet apo udhëzimet e tjera të mëparshme të kësaj natyre.

5.5. Obligohet Sekretarit i Përgjithshëm i Universitetit “Ukshin Hoti” që të bëjë ndryshimin e akt-emërimeve (personali administrative) dhe unifikimin e pagave të tyre me këtë rregullore.

5.6. Kjo rregullore është hartuar në bazë të unifikimit të pagave të personelit administrativ në Universitet publike të Republikës së Kosovës me miratimin e ministrive përkatëse (MAP, MASHT dhe MF).

Neni 6

Pagat e shërbyesve civilë dhe SHCK-të (në vlerë prej 31.20 €) sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje, janë të pasqyruara me rritje prej 4% sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 05/24 të datës 12.01.2018, i cili ka filluar të zbatohet nga 01.01.2018.

Kryesues i Këshillit Drejtues

Prof. asoc. dr. Bedri Muhadri

